



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /
GOVERNMENT OF KOSOVA



Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski Inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo

Raport Inspektimi Nr: 1/2014

VLERËSIMI I MENAXHIMIT TË TIKETAVE NË NJËSINË PËR KONTROLLIN E AUTOSTRADAVE



(Korrik 2014)

SHKURTESAT

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
PK –së	Policia e Kosovës
DKRR	Divizioni i Komunikacionit Rrugor
NjKA	Njësia për Kontrollin e Autostradave
NjKRR	Njësia e Komunikacionit Rrugor

P Ë R M B A J T J A

1. HYRJE

2. ORGANIZIMI DHE INFRASTRUKTURA LIGJORE NË NJKA

3. PROCEDURA E MENAXHIMIT ME TIKETA NË NJKA

4. TË GJETURAT

4.1 Identifikimi i infrastrukturës ligjore dhe përputhshmëria e zbatimit të saj lidhur me menaxhimin e tiketave të trafikut.

4.2 Vlerësimi i rregullshmërisë për plotësimin dhe procedimin e tiketave të trafikut

4.3 Identifikimi dhe evidentimi i mangësive dhe shkeljeve të mundshme lidhur me evidentimin dhe procedimin e tiketave të trafikut.

5. PËRFUNDIMET

6. REKOMANDIMET

1. HYRJE

1.1. Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, neni 24 pika 1, 2, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektimeve ka bërë Inspektim të jashtëzakonshëm nga data 05 deri me 08 maj 2014, në Njësinë për Kontrollin e Autostradave, me temën “Vlerësimi i menaxhimit të tiketave në Njësinë për Kontrollin e Autostradave”.

1.2. Qëllim i këtij inspektimit ishte vlerësimi i shqiptimit të tiketave në komunikacion konform procedurave në fuqi, përmirësimi i performancës policore në aspektin formal dhe organizativ në lidhje me procedurat e shqiptimit të tiketave nga Njësia për Kontrollin e Autostradave të Policisë së Kosovës.

1.3. Objektivat e këtij inspektimi ishin:

- Identifikimi infarstrukturës ligjore dhe dhe përputhshmëria e zbatimit të saj lidhur me menaxhimin e tiketave të trafikut.
- Të vlerësohet rregullshmëria e plotësimit dhe procedimit të tiketave të trafikut.
- Identifikimi dhe evidentimi i mangësive dhe shkeljeve të mundshme lidhur me evidentimin dhe procedimin e tiketave të trafikut.

1.4. Periudha e mbulimit të Inspektimit ka përfshi periudhën kohore prej 01.01.2014 deri me 30.04.2014.

1.5. Si kriter matës Inspektorati Policor i Kosovës ka marrë:

- Ligjin e Policisë së Kosovës;
- Ligji për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor
- Doracakun e Parimeve dhe Procedurave të PK-së;
- Procedura Standarde të operimeve për NjKA;
- Udhëzuesi për mënyrën e kryerjes së detyrave në mbikqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit rrugor.

1.6. Inspektimi në këtë fushë luan rol të rëndësishëm në:

- Ushtrimin e një kontrolli të menaxhmentit policor, për të siguruar shkallë më të lartë të efektshmërisë dhe efikasitetit në kryerjen e detyrave policore.
- Ngritjen e përgjegjësisë së punonjësve policorë në menaxhimin dhe procedimin e tiketave të trafikut.

1.7. Gjatë inspektimit të jashtëzakonshëm është përdorur kjo metodologji e punës:

- Kontrolli fizik i të gjitha kopjeve të tiketave të trafikut në NjKA gjatë periudhës së mbulimit,
- Kontrolli fizik i të gjithë bllokave të tiketave të pranuar dhe të dorëzuara nga NjKA dhe krahasimi i tyre me kopjet e tiketave të shqiptuara gjatë periudhës së mbulimit,
- Kontrollimi i raporteve të dorëzimit të kopjeve të tiketave në NjKRR Prizren, dhe
- Intervistimi i zyrtarëve si në vijim:
 - Komandantin e NjKA-së;
 - Zyrtarin për MTO – Logjistikë;
 - Zyrtarin për Tiketa

2. ORGANIZIMI DHE INFRASTRUKTURA LIGJORE NJËSINË E KONTROLLIT TË AUTOSTRADAVE

2.1 Organizimi në Njësinë e Kontrollit të Autostradave

2.1.1 Sipas strukturës organizative të PK-së, NjKA është në kuadër të Divizionit të Komunikacionit Rrugor. Kjo njësi është themeluar në vitin 2012, dhe vepron sipas strukturës organizative të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i PK-së me datë 20.05.2012. Struktura e aprovuar në listën e personelit parashihet që NjKA-ës të ketë në dispozicion për kryerjen e detyrave tridhjetë e tetë (38) punonjës, ku tre nga ta duhet të jenë staf civil dhe të tjerët zyrtarë policor.

2.1.2 Sipas kësaj struktura organizative NjKA brenda vetes ka të paraparë që të ketë Udhëheqësin e Operativës, Ekipet Patrulluese, Ekipin e Motoçikletave, Ekipin për Personel dhe Administratë, Ekipin për Shërbime Mbështetëse, Zyrën e Tiketave, dhe Radiokomunikuesin.

2.1.3 Vlen për tu theksuar që NjKA ka një zonë të përgjegjësis prej 104 km, ku e cila është e ndarë në tri sektore dhe atë në ;

Spektori 1- Vërmic - Gjurgjicë 61 km.

Spektori 2- Gjurgjicë - Besi 25 km.

Spektori 3 - Besi-Trude 18 km.

2.1.4 Nga tridhjetë e shtatë (37) punonjës sa janë në NjKA, tri (3) prej tyre janë të gjinisë femërore dhe tridhjetë e katër (34) të gjinisë mashkullore. Personel shqiptar janë tridhjetë e gjashtë (36), dhe një (1) i takon komuniteteve pakicë.

2.2 Infrastruktura ligjore në Njësinë e Kontrollit të Autostradës

2.2.1. NjKA veprimtarin e saj e ushtron duke u bazuar në Ligjin e Policisë, Ligjin për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, Doracakun Parimet dhe Procedurat e PK-së si dhe në Procedurën Standarde të Operimit (PSO) me titull "Menaxhimi, Kontrolli dhe Mbikqyrja e Autostradave të Kosovës" e cila është e miratuar me 07.05.2013, nga Drejtori i Departamentit për Operacione e cila në vete përmban përkrahimin e detyrave dhe përgjegjësi për personelin e NjKA-së dhe Udhëzues për mënyrën e kryerjes së detyrave në mbikëqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit rrugor cili është i miratuar me datë 14.05.2012 nga u.d. Ndihmës Drejtori i Përgjithshëm për Operacione,

2.2.2 Sa i përket bazës ligjore menaxhimi i tiketave është i rregulluar me "Udhëzues për mënyrën e kryerjes së detyrave në mbikëqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit rrugor" ku ky udhëzues ka të përcaktuar mënyrën e: dhënies, dorëzimit, rezhimit, ruajtjes dhe shkatërrimit për tiketat e dënimeve në komunikacion. Ndërsa sa i përket rregullimit të kryerjes së detyrave nga ana e zyrtarëve policorë, kjo qështje rregullohet me anë të PSO-së për NjKA-në.

3. PROCEDURA E MENAXHIMIT ME TIKETA NË NJKA

3.1. Sipas “Udhëzues për mënyrën e kryerjes së detyrave në mbikëqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit rrugor” secila Njësi Regjionale e Komunikacionit (NjRK), Drejtorit Rajonale apo Departamentet si dhe personat fizik të autorizuar nga Drejtoritë Rajonale apo Departamentet përkatëse do të furnizohen me tiketa – numrat e bllokave të tiketave dhe do të regjistrohen nga çdo pranues në formë elektronike dhe të shkruar.

3.2. NJKA pranon bllokat e tiketave nga divizioni i Komunikacionit Rrugor me anë të një fletëngarkimi, në të cilin shënohen këto të dhëna: numri i bllokave të pranuar, numri serik i bllokave, emri, mbiemri dhe numri i karteles së zyrtarit i cili bënë pranimin e bllokave si dhe të dhënat e zyrtarit i cili bënë dorëzimin e bllokave. Rolin e personit të autorizuar për menaxhim me bllokat e tiketave pranë NJKA-së është i caktuar zyrtari i MTO-Logjistik-ës (zyrtar policor). Ky zyrtar e bënë pranimin e bllokave të tiketave nga Divizioni i Komunikacionit Rrugor, shpërndarjen (ngarkimin) e bllokave të tiketave tek zyrtarët policor dhe gjithashtu pas hargjimit të bllokave të tiketave ai bënë pranimin e bllokut të hargjuar së bashku me një kopje të tiketës e cila mbetet në bllok.

3.3. Gjatë shpërndarjes së bllokave të tiketave tek zyrtarët policor mbahen regjistrat në të cilët janë të evidentuara të dhënat e zyrtarit policor i cili e ka pranuar bllokun e tiketave duke përfshirë numrin e kartelës së identifikimit, numrin serik të fillimit dhe përfundimit të tiketave të cilat gjenden në atë bllok.

3.4. Si rregull pas shpenzimit të bllokut të tiketave, zyrtari policor bllokun e hargjuar e kthen tek zyrtari i MTO-Logjistikës, bëhet kontrollimi i kopjeve të mbetura në bllok dhe më pas bëhet ngarkimi i zyrtarit policor me bllokun e ri të tiketave. Por, që gjatë punës së përditshme kanë ndodhur përjashtime ndaj rregullës së lartcekur në dy rrethana, dhe atë kur zyrtarët policor dalin në detyra patrulluese dhe bllokun e tiketave e kanë para përfundimit si dhe para fillimit të festave apo ditëve të vikendit.

3.5. Zyrtarët policor patrullues, pas përfundimit të orarit të punës të gjitha kopjet e tiketave të shqiptuara i dorëzojnë tek mbikëqyrësi i ndrrimit i cili pas kontrollimit dhe nënshkrimit i kthen tek zyrtari policor i cili është i ngarkuar me atë tiketë. Zyrtari policor tiketën e regjistron në librin e tiketave dhe e vendos në një kuti e cila gjendet në zyrën e rreshterëve, nga ku në çdo mëngjes i merr zyrtari i tiketave dhe i procedon për procedura të mëtejme.

4. TË GJETURAT

4.1. Identifikimi i infrastrukturës ligjore dhe përputhshmëria e zbatimit të saj lidhur me menaxhimin e tiketave të trafikut

4.1.1. Infrastrukturë ligjore e identifikuar përmbush nevojat për mbarvajtjen e punës për NJKA-në. Mirëpo ekzistojnë disa zbrastira si në mos implementimin e strukturës organizative në fuqi, si dhe në “Udhëzues për mënyrën e kryerjes së detyrave në mbikëqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit rrugor” dhe “Menaxhimi, Kontrolli dhe Mbikqyrja e Autostradave të Kosovës”.

4.1.2. Struktura organizative nuk është e funksionalizuar plotësisht sipas përcaktimeve të saj. Të gjeturat tregojnë se nuk funksionon Ekipi i Motoqikletave, Radiokomunikuesi, Personeli (staf civil) në Administratë dhe Shërbime Mbështetëse. Kurse Zyra e Tiketave nuk ka qenë funksionale deri me datën 26.03.2014, kur është caktuar një zyrtar policor që ta kryej detyrën e zyrtarit të tiketave. Mirëpo këtë funksion e ka kryer Asistentia Administrative.

4.1.3. Kurse sa i përket Udhëzuesit për Mënyrën e Kryerjes së Detyrave në Mbikqyrjen dhe Rregullimin e Komunikacionit Rrugor, si dhe PSO-së për NjKA, nuk precizojnë në mënyrë të qartë qështjen e menaxhimit të tiketave të trafikut. Pra, mungojnë informacionet se ku duhet të dorëzohen kopjet e tiketave pas nënshkrimit nga ana e mbikqyrësit të ndrrimit, si dhe kush duhet ti pranoj ato tiketa, edhe pse në praktikë zyratët policor patrullues, pas përfundimit të orarit të punës të gjitha kopjet e tiketave të shqiptuara i dorëzojnë tek mbikqyrësi i ndrrimit i cili pas kontrollimit dhe nënshkrimit i kthen tek zyrtari policor i cili është i ngarkuar me atë tiketë. Zyrtari policor tiketen e regjistron në librin e tiketave dhe e vendos në një kuti e cila gjendet në zyrën e rreshterëve, nga ku në qdo mëngjes i merr zyrtari i tiketave dhe i procedon për procedura të mëtejme.

4.1.4. Sipas udhëzuesit për tiketa konkretisht sipas nenit 97 të këtij udhëzuesi, çdo tiket e shqiptuar duhet të regjistrohet në Sistemin Informativ të Policis së Kosovës (SIPK). Edhe pse NjKA nuk e ka të instaluar këtë sistem, të gjitha kopjet e tiketave i dorëzon në NjKRR të Drejtoris Regjionale Prishtinë për regjistrim. Por, kjo qështje ka prodhuar një problematikë tjetër me ç'rast asnjë tiket e shqiptuar nga NjKA nuk është e regjistruar në SIPK, me arsyetimin e zyrtarëve se kjo ka ndodhë për shkak se gjatë vitit 2013, kanë pasë pengesa në sistem ku si pasojë ka ardhë deri të grumbullimi i një numri shumë të madhë të tiketave të cilat janë shqiptuar nga NjKRR Prishtinë.

4.1.5. Mungesën e SIPK-ut si dhe mungesën e zyrtarit përgjegjës për tiketa dhe për futjen e të dhënave në SIPK në NjKA, e kanë mbuluar duke e angazhuar me punë shtesë Asistenten Administrative e cila kishte improvizuar një Bazë të të Dhënave dhe ku i kishin regjistruar të gjitha tiketat e shqiptuara nga zyrtarët policor të NjKA-së. Praktikë e njëjtë është duke vazhduar edhe pas caktimit në detyrë të zyrtares së tiketave, pra tani regjistrimi i tiketave në bazën e të dhënave të improvizuar e kryen zyrtari i tiketave.

4.1.6. Në PSO-në e NjKA, nuk janë të përshkruar fare detyrat dhe përgjegjësit e zyrës së tiketave. Poashtu përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të mbikqyrësve të ndrrimeve dhe zyrtarëve policor patrullues nuk ka përfshir përshkrimin sa i përket formës së procedimit të kopjeve të tiketave të cilat ju kanë shqiptuar kundërvajtësve.

4.2. Vlersimi i rregullshmërisë për plotësimin dhe procedimin e tiketave të trafikut

4.2.1. Sa i përket formës dhe rregullësis së plotësimin të tiketave kjo qështje është e rregulluar gjithashtu me udhëzuesin për tiketat, konkretisht në nenin 85 “Udhëzime për Shkruarjen e Tiketave në Trafik”. Sipas këtij udhëzuesi zyrtarët policor duhet ta plotësojnë me shkrim të qartë dhe të lexueshëm qdo rubrikë të tiketës së standardizuar, duke përfshirë pjesën qëndrore ku bëhet përshkrimi i kundërvajtjes së shkaktuar. Duhet theksuar se nga tiketat e kontrolluara është vërejtur se pothuajse të gjitha tiketat plotësoheshin konform udhëzuesit, duke përfshirë edhe nënshkrimin nga ana e mbikqyrësit të ndrrimit. Megjithatë janë hasur raste kur nuk janë plotësuar të gjitha rubrikat e parapara. Gjithashtu janë identifikuar shtatë (7) raste kur në tiketë mungon nënshkrimi i mbikqyrësit të ndrrimit siç ishte rasti i tiketave me numër: 01217660, 01201456, 01106574, 01195542, 01106577, 01128325, 01274649.

4.2.2. Gjithashtu kemi hasur në raste kur tiketa nuk ka qenë e nënshkruar as nga mbikqyrësi i ndrrimit por as edhe nga njëri prej zyrtarëve policor i cili ka qenë në patrull, por që tiketa ka qenë e nënshkruar vetëm nga njëri zyrtar policor i patrullës, siç ishte rasti i pesë (5) tiketave me numër: 01274649, 01106574, 01106577, 01128325, 01217660. Ndërsa në dy (2) raste me numër 01110628, 01180994, mbikqyrësi është nënshkruar por jo edhe njëri nga zyrtarët policor.

4.2.3. Kurse sa i përket procedimit të bllokut të tiketave të cilat kur kanë përfunduar ato janë kthyer tek zyrtari i MTO- logjistikës, me të cilin rast është respektuar në përputhshmëri të plotë neni 83 i Udhëzuesit për Mënyrën e Krerjës së detyrave në mbikqyrjen dhe rregullimin e Komunikacionit Rrugor.

4.2.4. Vendorsja e kopjeve të tiketave bëhet në kuti druri dhe atë për shkak të mungesës së sirtarëve adekuat. Por, IPK ka siguruar kopje të procesverbaleve që udhëheqësi i NJKA-së konkretisht komandanti i kësaj njësie i kishte paraqitur tek menaxhmenti i DKRR- së, për sigurimin e sirtarëve adekuat për vendosjen e tiketave kundërvajtëse.

4.3. Identifikimi dhe evidentimi i mangësive dhe shkeljeve të mundshme lidhur me evidentimin dhe procedimin e tiketave të trafikut.

4.3.1. Sa i përket këtij objektivi, Inspektimi është fokusuar në dy drejtime, që ka përfshi kontrollimin fizik të gjithsejt 8390 kopje të tiketave për periudhën kohore katër mujore (01.01.2014 -30.04.2014), si dhe kontrollimin e bllokut të tiketave që në vete përmbajnë kopjen e pestë të tiketës, gjë që ka përfshi kontrollimin e gjithsejt 331 blloka të tiketave me gjithsejt 6620 kopje të tiketave.

4.3.2. Nga kontrollimin fizik i 8390 kopjeve të tiketave janë identifikuar gjithsej 17 tiketa në të cilat ka pasur ndryshime apo ndërhyrje tek plotësimi i tyre. Në tri (3) nga këto tiketa është bërë ndryshimi nga shqiptimi i tiketës me gjobë në shqiptim të tiketës për gjykatë, kurse në 14 tiketat e tjera ndryshimi është bërë nga shqiptimi i tiketës për gjykatë në shqiptim të tiketës me gjobë duke e përcaktuar vlerën e gjobës.

4.3.3 Andaj, për shpjegim të mëtejme nga numri i përgjithshëm i tiketave ku janë vërejtur ndërhyrjet, gjashtë (6) prej tyre janë proceduar për në gjykatë kurse 11 tiketa janë proceduar për dënimin me gjobë (apo dënim Jo mandator).

4.3.4. Për hollësi të mëtutjeshme, gjatë kontrollimit të shtatëmbëdhjetë (17) tiketave, është evidentuar se në nëntë (9) prej tyre ndryshimit janë në përputhje edhe në kopjën e mbetur në bllokun e tiketave, përkundër që në (3) tiketa ndryshimi në tiketë nuk përputhet nga kopja e parë me të pestën. Në katër (4) tiketa në të cilat vërehen ndryshimet janë nga bllokat me nga katër kopje, kurse një (1) tiketë nuk i ka takuar fare NJKA-së por që është shkruar nga zyrtarët policor të Njësisë për Përcjelljen e Materieve të Rrezikshme.

4.3.5. Vlen për tu theksuar që në tiketa ka pasur ndërhyrje ose ndryshim të kundërvajtjes duke përfshir edhe nenin i cili e përcakton kundërvajtjen. Pra, ka ndryshime nga shqiptimi i denimit për gjykatë në atë me gjobë dhe anasjelltas.

4.3.6. Po ashtu është evidentuar në një rast kur në bllokun e tiketave mungonin tri kopje të tiketave (01178515, 01178516 dhe 01178520), me ç'rast ishte përpiluar një "raport i policit", ku ishin paraqitur arsyet apo shkaqet e mungesës së kopjeve në bllokun e tiketave. Gjatë analizimit të "raportit të policit" si dhe krahasimit me kopjet e fotokopjuara nga fleta e parë e tiketës, inspektorët kanë vërejtur se një nga këto tri kopjet e tiketave është shkruar një ditë mbas datës së raportimit, që konkretisht bëhet fjalë për tiketën me numër 01178520.

4.3.7. Nga data 04.03.2014, Blloku i tiketave përmbanë 25 tiketa që janë të shtypura në katër kopje, gjë që ka bërë që të mos mbetet asnjë kopje të tiketës në bllok për kthim nga zyrtari policor tek zyrtari i autorizuar. Po ashtu në këtë llojë blloku të tiketave nuk mbetet kopje për arkiv, si dhe pamundësohet që të përcillet procesi i shpenzimit të tiketave nga ana e zyrtarëve policor.

4.3.8. Gjatë kontrollimit të listës për procedimin e tiketave si dhe verifikimit të tiketave është vërejtur se ka pasur raste kur një kundërvajtësi në të njejtën kohë i janë shqiptuar dy e më shumë tiketa, gjë që bie ndesh me infrastrukturën ligjore apo konkretisht me dispozitën që rregullon qështjën konkrete.

5. PËRFUNDIMET

5.1. Mos planifikimi dhe menaxhimi jo i mirëfilltë sa i përket nevojave të punës ka bërë që në NJKA-ve, të mos funksionojnë Ekipi i Motoqikletave, Zyra e Tiketave, Radiokomunikuesi, si dhe Personeli (stafi civil) në Administratë dhe Shërbime Mbeshtetëse. Andaj, si rezultat i kësaj kemi mos funksionalizim të strukturës organizative sipas përcaktimeve që janë aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i PK-së.

5.2. Edhe për kundër faktit të ekzistimit të infrastrukturës ligjore për mbarëvajtjen e punës në menaxhimin e tiketave, disa nga qështjet që nuk janë të precizuara në mënyrë konkrete dhe të cilat përfshijnë: informacionet për dorëzimin e kopjeve të tiketave pas nënshkrimit nga ana e mbikqyrës të ndërrimit si dhe mos parashikimi lidhur me formën e procedimit të kopjeve të tiketave që u janë shqiptuar kundërvajtësve i ka parapri një boshllëku për mbarvajtjen e punës.

5.3. Mos funksionalizimi i SIPK- data bazës në NJKA ka bërë që regjistrimi i tiketave të bëhet nga ana e NJKRR-Prishtinë, gjë e cila nuk është realizuar për shkak të ngarkesave tjera që kanë dal si rezultat i regjistrimit të tiketave nga NJKRR-Prishtinë. Megjithatë IPK inkurajon zyrtarët policor për punën e mirë të kryer në evidentimin dhe regjistrimin e tiketave në bazën e të dhënave të improvizuar.

5.4. Sa i përket rregullshmërisë së plotësimit dhe procedimit të tiketave janë identifikuar disa raste që zakonisht janë lidhur me mos plotësimin e disa hapësirave që ka parapri formulari i tiketës ku nuk janë nënshkruar qoftë nga ana e zyrtarëve policor si dhe mbikqyrës i ndërrimit. Kurse sa i përket procedimit të tiketave gido gjë ka qenë konform rregullave të parapara.

5.5. Nga gjithsej 8390 tiketa të kontrolluara si dhe 331 blloka të tiketave me gjithsej 6620 kopje të tiketave të cilat janë të proceduara në periudhën e mbulimit, janë evidentuar gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) raste në të cilat kishte ndryshime apo ndërhyrje të ndryshme. Me qenë se Udhëzuesi për Mënyrën e Kryerjes së Detyrave në Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Komunikacionit Rrugor, nuk e rregullon me ndonjë dispozitë qështjën e kompetencës në ndërhyrje apo përmirësim të tiketës ka bërë që për IPK-së të jetë e pamundur të përcaktohen shkaqet e këtyre veprimeve të ndërmarra.

5.6. Aplikimi i bllokave të tiketave të shtypur në katër kopje, për IPK-në është në kundërshtim me nenin 86 të Udhëzuesit për mënyrën e kryerjes së detyrave në mbikëqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit rrugor, pasi që nuk mbetet në bllok asnjë kopje për arkiv. Gjithashtu do të jetë pothuajse e pamundur të përcjellet gjendja se zyrtarët policor a i kanë shpenzuar të gjitha tiketat e pranuar.

5.7. Vlenë të theksohet që tiketat kundërvajtëse që shënohen nga NJKA në zonën e përgjegjësis të DRP Prizren, dorëzohen në NJKRR Prizren. Dorëzimi i tiketave nga NJKA në NJKRR Prizren bëhet me qëllim të procedimit të mëtutjeshëm nga NJKRR për gjykatë apo edhe për dënime me gjobë. Inspektimi i kryer në NJKRR Prizren ka nxjerrë në pahë se të gjitha tiketat e dorëzuara nga NJKA për procedim të mëtutjeshëm ishte kryer me anë të plotësimit të formularve të pranim dorëzimit, ku në këta formular figuronin nënshkrimet e të dy zyrtarëve që kanë kryer pranim dorëzimit.

6. REKOMANDIMET:

1. IPK rekomandon menaxhmentin e lartë të Divizionit të Komunikacionit Rrugorë, që t'i rishikoj PSO-në Menaxhimi, Kontrollimi dhe Mbikqyrja e Autostradave të Kosovës, si dhe Udhëzuesin për Mënyrën e Kryerjes së Detyrave në Mbikqyrjen dhe Rregullimin e Komunikacionit Rrugor. Në mënyrë që të bëhet përkrahimi i plotë i detyrave dhe përgjegjësi të zyrtarëve policor, të përcaktohet mënyra e rrugëtimit të kopjeve të tiketave gjatë menaxhimit të tiketave si dhe jepen skjarimet e qarta lidhur me të drejtën dhe mundësin e përmirësimit të tiketave.
2. IPK rekomandon menaxhmentin e Divizionit të Komunikacionit Rrugor, që në afat sa ma të shkurtër kohor të siguroj inventarin e nevojshëm për vendosjen dhe ruajtjen e sigurt të tiketave të shqiptuara. Gjithashtu duhet të sigurohen pajisjet e nevojshme si dhe instalimi i bazës së të dhënave (SIPK) në mënyrë që regjistrimi i kundërvajtësve të bëhet konform rregullativës në fuqi.
3. IPK rekomandon Komandantin e NjKA-së dhe mbikqyrësit e ndërrimeve që të ushtrjnë një mbikëqyrje dhe kontrollë rigoroze sa i përketë plotësisht dhe nënshkrimit të tiketave, në mënyrë që në të ardhmen asnjë tiketë të mos mbetet e pa plotësuar konform rregullave dhe e pa nënshkruar nga mbikqyrësit e ndërrimeve.
4. IPK rekomandon Menaxhmentin e Lartë të Divizionit të Komunikacionit Rrugor që ti zbatoj me përpikëri udhëzimet të cilat rrjedhin nga "Udhëzuesi për mënyrën e kryerjes së detyrave në mbikëqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit rrugor" dhe ti kthej në përdorim bllokat e tiketave me pesë kopje ose në të kundërtën duhet të rishikohet ky udhëzues dhe të specifikohen në mënyrë të kurtë shpërndarja e kopjeve të tiketave.